



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 87

Prishtinë, më 24.9.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës-vëzhgues tjerë të cilët janë evidentuar sipas listës për pjesëmarrje.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.9.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Pyje në parim,
4. Caktimi i grupeve punuese për Ujëra dhe Agjencinë e Komplekseve memoriale,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.9.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.9.2012 me përmirësime nga Liburn Aliu.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Pyje në parim

Kryetari i Komisionit konstatoi rëndësinë e veçantë që ka ky Projektligj por njëherit edhe me probleme të theksuara, ndaj propozoi Komisionit që të kërkohet përgjigja nga Qeveria rreth përgjegjësisë për Pyje, ngase si theksoi ai, nëse kalojnë përgjegjësitë në një ministri atëherë do të kemi menaxhim të mirëfilltë. Ky domosdoshmëri rrjedhë nga fakti se të gjitha çështjet siç janë ujërat, pyjet, parqet janë ngushtë të lidhura për nga funksionaliteti.

Liburn Aliu duke arsyetuar këtë shkresë që do ti drejtohej Qeverisë, tha se me Projektligjin që kemi përpara asgjë nuk është ndryshuar, problemet kanë mbetur ashtu si janë sa i përket niveleve të menaxhimit, APK me kompetenca të mshefura, Komunitat nuk kanë kompetenca asgjë përveç të japin ca pëlqime për tenderë, ndaj sipas tij kjo është një tallje e thjeshtë, ngase problemet e vendeve të punës janë rregulluar nga ministritë, ndërsa tani për shkak të pamundësisë që ti heqin ato vende, ja dërgojnë përgjegjësinë Kuvendit që të mirët me ato probleme. Kundërshtoi ligjin e propozuar.

Sevdije Lama shfaqti brengosjen mos po kushton financiarisht shumë ky propozim i Kryetarit, dmth bartja e departamenteve prej njëres tek tjetra etj. **Reagoi kryetari** dhe tha që kjo do të ishte edhe zvogëlim i shpenzimeve, ngase një ministri do të ngarkohej për çështjet e cekura më lart.

Daut Haradinaj pohoi faktet që ceku Liburn Aliu sidomos për kompetencat e mshefura të APK ngase ata japin pëlqimin pastaj thonë “nuk dimë asgjë”, dhe shtoi se vetëm një fjalë ka lidhur me pyje : krimi i organizuar. Gjithashtu apeloj që komisioni duhet të insistoi në ndarjen e kompetencave menaxhuese, ngase një titullar do të menaxhoi ma mirë, padyshim (ceku problemet në Deçan). U pajtua edhe me kryetarin edhe me nënkryetarin (Liburn Aliu).

Nijazi Idrizi potencoi përkufizimet e Projektligjit të propozuar të cilat duhet të standardizohen me BE dhe pohoi se me gjithë këto struktura të krijuara me siguri do të kemi probleme menaxhuese, njëherit polemizoi me **Daut Haradinaj** rreth arsyes së mbajtjes së armëve nga ana e rojtarëve të pyllit ngase si tha ai nuk mbrohen pyjet me armë, z. Haradinaj nuk kundërshtoi mbajtjen e armëve nga rojtarët mirëpo ishte i mendimit se ky është një problem i vogël teknik për të cilin ka kush të mendoj (Qeveria), më kryesore do të ishte ndalimi i dy defekteve të mëdha : shkatërrimi i pyjeve nga niveli regional dhe grupet ilegale në nivelin lokal, përfundoi.

Salih Morina u pajtua me shumicën e vërejtjeve që u dëgjuan dhe të cilat duhet ti numërohen Qeverisë dhe shtoi edhe problematikën e financimit të Ligjit i cili do të mungoj nga viti 2013, ndaj sugjeroi kthimin e projektit Qeverisë për të përmirësuar sipas sugjerimeve të cekura në mbledhjen e sotme dhe me pyetjen për MFE a do të ketë financim ligji apo jo (deklarata financiare).

Liburn Aliu kërkoi shkurtimin e niveleve të shumta menaxhuese ngase në këtë komision nuk ekziston mundësia e ndryshimeve esenciale, ndërsa **Afërdita Berisha** gjithashtu kërkoi ndryshimin e sistemit të proklamuar në MB ngase e njëjta asgjë nuk ka ndryshuar deri tani. **Nijazi Idrizi** arsyetoi veprimtarinë e APK dhe kërkoi ngritjen e nivelit të lartë për mbrojtjen e zonave që duhet të mbrohen sipas nenit 61 dhe ishte kundër dërgimit të përgjegjësive për pyjet në MMPH sepse ky është konflikt interesi. Përgjegjësia për zonat e mbrojtura dhe përgjegjësia për shfrytëzim ekonomik (prerje të pyjeve), nuk bënë të jenë në një Ministri. Neni 61 i Ligjit mbi Pyjet, përgjegjësinë për pyjet edhe në zonat e mbrojtura ia dedikon APK-së, përfundoi.

Sipas votimit 7 me 2 PËR Komisioni nxori si vijon :

P Ë R F U N D I M

Të dërgohet shkresa Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe dy ministrave, të bujqësisë dhe të mjedisit, me të cilin do të kërkohet përgjigja rreth kompetencave dhe

përgjegjësi për pyjet, për shkak të mosfunksionimit të mirëfilltë të sistemit të deritanishëm të menaxhimit me pyje.

Pas përgjegjës së arritur , komisioni do të vendos për procedimin e mëtejshëm të Projektligjit.

4. Caktimi i grupeve punuese për dy Projektligje

Kryetari i Komisionit konstatoi se **Projektligji për Ujërat e Kosovës** ka problematikën e ngjashëm ngase duhet të vendoset për ZRRUM ku duhet të ketë vendin, të bartet në MMPH apo ndonjë mënyrë tjetër e veprimit, njëherit sugjeroi ekspertin përkatës. U formua grupi punues prej : **Nait Hasani-kryesues, Salih Morina, Etem Arifi dhe Daut Haradinaj.**

Për **Projektligjin e Agjencisë për Komplekset Memoriale** u angazhua Komisioni komplet rreth shqyrtimit në grupin punues, ndërsa për shkak se u kërkua ekspert juridik për këtë lëmë, **Kryetari** sugjeroi raportin nga juristët e Kuvendit, përkatësisht njësisë për standardizim.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit njoftoi për takimin e GP për monitorimin e Ligjit për Ajrin dhe Zhurmën ku janë harmonizuar qëndrimet rreth monitorimit në fjalë. Pas konsultimeve edhe për disa detale rreth matjeve të ajrit dhe zhurmës, pritet të bëhen vizitat në vendet e sugjeruara, për të krijuar mundësinë e hartimit të rekomandimit për Kuvendin e Kosovës.

Gjithashtu Kryetari njoftoi për **Peticionin e Rugovasëve** të dërguar në këtë Komision, të cilët janë ankuar për çështjet pronësore, probleme të cilat Komisioni i ka rregulluar duke propozuar amendamentin përkatës me të cilin hiqen brengat e qytetarëve se me Ligjin për Parkun Kombëtar mund të rregullohen çështjet pronësore.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani